



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

Dokument parlamentar

RAPORT REKOMANDUES

(i deputetëve të shumicës anëtarë të Këshillit)

Për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për dhënie autorizimi për arrestim/heqje lirie për deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit, përcjellë me shkresën nr. 16688 prot, datë 12.12.2023.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në cilësinë e organit përgjegjës parlamentar, në përputhje me nenin 13 dhe nenin 118, të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e datës 18.12.2023, ora 12:00, zhvilloi procedurën e shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, (referuar në vijim, si Prokuroria e Posaçme), për dhënie autorizimi për arrestim/heqje lirie për deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, zhvilloi procedurën e shqyrtimit të kërkesës bazuar në dispozitat Kushtetuese në aktet ligjore në fuqi dhe në Rregulloren e Kuvendit.

BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS

Shqyrtimi i kërkesës për dhënie autorizimi për arrestim/heqjen e lirisë së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjen rregullim në dispozitat Kushtetuese, Kodin e Procedurës Penale dhe Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë:

- Kushtetuta, nenet 73, 135 dhe 148;
- Kodi i Procedurës Penale, nenet 288 dhe 289;
- Rregullorja e Kuvendit, nenet 13 dhe 118.

Neni 73, pika 2 dhe 4 e Kushtetutës

“2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit...”

4. Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur.”

Neni 135, pika 2 e Kushtetës:

“Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.”

Neni 148, pika 4 e Kushtetutës

....” 4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.”

Neni 288, pika 1 dhe 2 e Kodit të Procedurës Penale

” 1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi.

2. Kërkesa për autorizim paraqitet kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në këtë Kod për kryerjen e veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ajo shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij.”

Neni 289 i Kodit të Procedurës Penale

*1. Mosdhënia e autorizimit, sipas nenit 288, të këtij Kodi, **nuk e pengon prokurorin që të kërkojë një masë tjetër sigurimi, sipas nenit 244, dhe as të procedojë ndaj tij ose personave të tjerë, ndaj të cilëve zhvillohen hetime për të njëjtin fakt...***

Neni 13 dhe 118 i Rregullores së Kuvendit

Neni 13

“ 5. Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, ose heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ose ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti në përputhje me nenin 73 të Kushtetutës. Shqyrtimi i kërkesës bëhet sipas procedurës së parashikuar në nenet 118 dhe 119 të kësaj Rregulloreje.

6. Këshilli mblidhet me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit ose 1/2 së anëtarëve. Rendi i ditës caktohet nga Kryetari. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme.

7. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli i paraqet Kryetarit raportin, i cili përmban të gjitha qëndrimet për çështjen. Raporti i përcillet seancës plenare brenda dy javëve nga përfundimi i shqyrtimit të çështjes. Raporti paraqitet nga relatori/relatorët. Rregullore për komisionet e përhershme.”

Neni 118

“1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës i paraqitet Kryetarit të Kuvendit nga prokurori. Kryetari ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet dhe vë në dijeni deputetin.

2. Deputeti, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha në të cilën Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës. Deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes, të përfaqësohet me mbrojtës ligjor, të drejtojë pyetje dhe të kërkojë sqarime në lidhje me kërkesën me qëllim të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes.

3. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda 2 javëve harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës. Raporti i Këshillit u shpërndahet deputetëve.

4. Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo të kontrollit personal ose të banesës të një deputeti vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të hapur për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës ndaj deputetit.

5. Në rastin kur Kuvendi nuk merr vendim për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës të një deputeti brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa konsiderohet e rrëzuar nga Kuvendi. 6. Përcaktimet e bëra në këtë nen zbatohen edhe në rastet e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës të anëtarit të Këshillit të Ministrave.”

I. ASPEKTE PROCEDURALE

Prokuroria e Posaçme me shkresën nr. 16688 prot, datë 12.12.2023 ka depozituar në Kuvend në datën 12.12.2023 kërkesën “Për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit”. Kjo kërkesë ka bashkangjitur një relacion dhe provat përkatëse, fiksuar në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit.

Me depozitimin e kësaj kërkesë, në përputhje me nenin 13 dhe nenin 118, pika 1, të Rregullosës së Kuvendit, Kryetarja e Kuvendit ka nxjerrë urdhrin nr. 3822/2, datë 12.12.2023, për thirrjen e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt: shqyrtimin e kërkesës “Për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit”, si dhe ka dërguar menjëherë kërkesën,

relacionin dhe provat pranë Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të vijuar procedurën parlamentare.

Më shkresën nr. 3822/3, datë 12.12.2023, Kuvendi i ka komunikuar deputetit z.Sali Berisha datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, si dhe kërkesën e Prokurorisë së Posaçme së bashku me relacionin dhe provat.

Me shkresën nr. 3822/4, datë 12.12.2023, Kuvendi i ka komunikuar Prokurorisë së Posaçme datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit.

Këshilli mori në shqyrtim kërkesën e Prokurorisë së Posaçme në mbledhjen e datës 18.12.2023, ora 12.00, në selinë e Kryesisë së Kuvendit, ku morën pjesë përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme, z. Arben Kraja, dhe znj. Enkeleda Millonai, në cilësinë e prokurorëve të çështjes, si dhe avokatët, z. Genc Gjokutaj e z. Sokol Mëngjesi, me prokurë nr. Rep 2401., Nr. Kol 1043, të datës 15.12.2023, si përfaqësues ligjorë të deputetit z.Sali Berisha.

II. RRETHANAT DHE ARSYETIMI PARASHTRUAR NGA PROKURORIA E POSAÇME

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 287 të vitit 2020 për veprën penale të *"Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në datën 2.10.2023, në kuadrin e këtij procedimi penal, është vendosur, ndër të tjera, regjistrimi i emrit të personit nën hetim Sali Berisha, si i dyshuar se ka kryer veprën penale të: *"Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë"*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25 të Kodit Penal.

Kjo dispozitë parashikon: *"Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet"*.

Sipas organit të akuzës: nga hetimet, vlerësohet së është krijuar dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova se personi nën hetim Sali Berisha, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, përgjatë periudhës kohore që shtrihet që nga viti 2005 e vijim, ka kryer veprime konkrete, aktive, në miratim ligjesh apo aktesh nënligjore, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familje ish-pronare, me qëllim kthimin dhe në vijim shfrytëzimin si troje ndërtimore të territoreve ku janë shtrirë ish-Klubi Shumësportesh "Partizani" dhe ish-Klubi i Futbollit "Partizani", ku përfitues i drejtpërdrejtë, ndër të tjerë, rezultonte të ishte bashkëshorti i vajzës së tij, shtetasi Jamarbër Malltezi. Nga ana e shtetasit Sali Berisha janë kryer veprime aktive, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e kontrolleve administrative (Urdhri nr. 1289 prot., datë 16.4.2009), me qëllim ushtrimin e presionit

dhe dhënien e urdhrave konkretë për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin përfundimin e procesit të privatizimit, në favor ndër të tjera të shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshorti i vajzës së tij. Nga ana e shtetasit Sali Berisha janë kryer veprime aktive në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë në vendosjen në dispozicion të shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshorti i vajzës së tij, të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të privatizimit të pronës shtetërore në favor të tij. Përfitimi i parregullt në favor të shtetasit Jamarbër Malltezi, në cilësinë e bashkëshortit të vajzës së Kryeministrit, shtetasit Sali Berisha, ekziston dyshimi se është vetë privatizimi i objekteve sportive, me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë, ndryshuar destinacionin dhe përdorur për përfitime materiale nga shtetasi Jamarbër Malltezi. Përfitim i parregullt janë ndryshimet e kryera në lidhje me destinacionin e zonave nga sportive në të banimit, pavarësisht interesit publik që ekziston në lidhje me nevojën e ekzistencës së ambienteve sportive, gjë që ka çuar në kryerje ndërtimesh, nga të cilat ka përfituar drejtpërdrejt shtetasi Jamarbër Malltezi. Përfitim i parregullt janë gjithashtu të gjitha përfitimet monetare që ka marrë shtetasi Jamarbër Malltezi nga shoqëria "Homeplan" sh.p.k. para se të deklarohej si bashkortak në këtë shoqëri, si dhe fitimet e akumuluar ndër vite të kësaj shoqërie dhe të shpërndara në vijim pas deklarimit të tij si bashkortak, të llogaritura në shumën 672 976 832 lekë ose 5 420 345 euro. Vepra penale e korrupsionit pasiv, e cila në vetvete ka qëllimin e përfitimit, evidenton qartësisht se përfitimi mund të jetë jo vetëm për vete, por edhe për persona të tjerë. Në rastin konkret është evidentuar pikërisht se ky përfitim është marrë nga personi nën hetim Jamarbër Malltezi.

Mbështetur në sa më sipër, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke kërkuar caktimin e masave të sigurimit personal "*Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe "*Ndalim i daljes jashtë shtetit*", parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale, për personin nën hetim z.Sali Berisha.

Me vendimin nr. 112 date 20 .10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke caktuar masat e sigurimit personal të sipërcituara për personin nën hetim z.Sali Berisha.

Me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë ka vendosur ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "*Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale , caktuar me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ndaj personit nën hetim Sali Berisha, duke u urdhëruar ky i fundit të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, para oficerit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe urdhërimi i këtij shtetasi të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1, të K.Pr.Penale dhe ndalimi i përdorimit të pasaportës dhe dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

Duke mos qenë dakord me dy vendimet e mësipërme, nga ana e personit nën hetim dhe mbrojtësve të tij është ushtruar ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tirane.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, **me vendimin nr. 56, datë 21.11.2023**, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të verifikuar me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 të së njëjtës gjykatë, ndaj ankuesit z. Sali Berisha.

Referuar procesverbaleve të **datave 06.11.2023, 20.11.2023 dhe 04.12.2023** të mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore/hetuesi, para të cilit duhet të paraqitej personi nën hetim Sali Berisha, rezulton se ky i fundit nuk ka zbatuar vendimin e gjykatës, duke mos u paraqitur asnjëherë para policisë gjyqësore.

Në këto rrethana Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë në bazë të nenit 73 të Kushtetutës dhe nenit 288 e nenit 289 të K.Pr.Penale për të kërkuar autorizim për arrestim/heqje lirie për deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit, duke e bazuar këtë kërkesë dhe në: nenin 289 i K.Pr. Penale, "*Lejimi për të kryer veprime*", (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014; ndryshuar me ligjin nr. 35; datë 30.3.2017) që parashikon: "...2. Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo kur nga hetimet rezultojnë fakte ose rrethana të reja, prokurori mund t'i kërkojë Kuvendit autorizim, sipas paragrafit 1 të nenit 288 të këtij Kodi. ... dhe nenin 231 të K.Pr.Penale, "*Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal*", që parashikon: "*1. Në rast shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese ."* si dhe nenin 260 të K.Pr.Penale, ku shprehimisht thuhet: "*Revokimi , zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit*", parashikon: "...3. Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese. 4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pese ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar, sipas nenit 248, të këtij Kodi, në rastet e parashikuara nga paragrafi 6 të nenit 246 të tij, gjatë procedimit për sigurimin e provës, gjatë seancës paraprake ose gjatë gjykimit."...

Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar se nga hetimet e kryera ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova se nga ana e personit nën hetim Sali Berisha është konsumuar vepra penale "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i K.Penal. Organi i akuzës parashtron se ekzistojnë kushtet dhe kriteret për

caktimin e masave të sigurimit dhe ekzistenca e këtyre kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenet 228, 229 të K.Pr.Penale, janë vlerësuar dhe konfirmuar tashmë nga gjykatat e posaçme.

Organi i akuzës ka vlerësuar se ndodhemi edhe në përmbushje të kërkesave të parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të K.Pr.Penale. Personi nën hetim Sali Berisha, në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore/hetuesit.

Pas parashtrimit të kërkesës nga ana e Prokurorëve, deputetët u drejtuan pyetje prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme për t'u sqaruar rreth objektit të kërkesës dhe çështjeve të parashtruara nga ana e tyre.

Në pyetjet drejtuar përfaqësuesve të Prokurorisë së Posaçme deputetët kërkuar të sqaronin çështje si: i) nëse Prokuroria e Posaçme ka patur ndikim apo ndërhyrje politike apo të ndonjë natyre tjetër për këtë çështje; ii) a është vënë deputeti në dispozicion të organit të akuzës apo i ka penguar hetimet; iii) cilat janë arsyet pse kërkohet masa e sigurimit personal, nevojat për këto masa dhe cilën nga masat vlerësojnë të kërkojnë në gjykatë; iv) nëse ka patur Prokuroria e Posaçme presion të cfarëdolloj natyre për këtë çështje etj.; v) pse nuk u veprua njësoj me kërkesën për autorizim drejtuar Kuvendit si në rastet e mëparshme (kërkesa për dhënie autorizimi për masë sigurimit për ish deputetin Saimir Tahiri)?

Prokurori, Z.Kraja në përgjigjet e tij theksoi se: në lidhje me politizimin e çështjes *nuk ka asnjë veprim politik që nga momenti që është regjistruar deri në momentin që jemi sot dhe nuk do të ketë asnjë ndikim politik deri në zgjidhjen përfundimtare. Çdo kërkesë është bërë bazuar në provat që janë mbledhur në dosje. Të gjitha materialet që janë në dosje i kemi paraqitur pranë gjykatës për vlerësim. Gjykata ka vlerësuar në favor të SPAK-ut deri më tani.*

Gjithashtu, z.Kraja argumentoi se *SPAK ka vepruar bazuar në legjislacionin në fuqi. Kemi paraqitur atë kërkesë që na ka miratuar edhe gjykata. Jemi të bindur dhe i qëndrojmë kësaj deri në fund. Do t'iu referohemi kushteve të pretendimit. Kur një deputeti duhet t'i caktohet masa e arrestit, burg ose shtëpi, prokurori kërkon autorizim. Gjithë debati është se çfarë do të thotë heqje lirie. Heqje lirie nuk është kufizim. Një nga masat shtrënguese që parashikohet është shtrimi i përkohshëm në spital psikiatrik. Nëse ne vijmë me kërkesë për arrest dhe Kuvendi nuk e miraton, masat e tjera janë ato që ju thashë unë. Në atë kohë prokuroria ka kërkuar arrest në burg apo kontrollë. Gjithë debati zhvillohet mbasi janë bërë ndryshimet kushtetuese për kufizimin e imunitetit. Gjithë debati është zhvilluar deri kur ka të drejtë prokuroria. S'kemi vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese për të pezulluar kërkesën.*

Ndërsa në lidhje me masën e sigurisë personale që do të kërkohet nëse Kuvendi do të autorizojë Prokurorinë e Posaçme, Z. Kraja u shpre se: *theksojmë se ato janë të ndryshme nga pikëpamja e rëndësës. Ne kemi paraqitur kërkesë për ashpërsim, këto janë dy masat që mund të përdoren, kemi kërkuar leje për të dyja. Në varësi të akteve të dosjes dhe vendimmarrjen tonë si prokurori, do t'i kërkojmë gjykatës njërën prej masave, se çfarë do të bëjë gjykata është tjetër punë.*

III. PARASHTRIMI I PËRFAQËSUESVE TË DEPUTETIT SALI BERISHA

Kërkesa paraprake

Në mbledhjen e datës 18.12.2023 u paraqitën përfaqësuesit e deputetit Sali Berisha, avokatët z.Genc Gjokutaj dhe z.Sokol Mëngjesi. Avokati Genc Gjokutaj parashtroi para Këshillit **kërkesën paraprake duke kërkuar pezullimin e mbledhjes së Këshillit, me argumentin se çështja është dërguar në Gjykatën Kushtetuese dhe se mbledhja nuk mund të shqyrtohet deri në daljen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese.**

Avokatët vunë në dijeni Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin se në momentin që zhvillohet mbledhja e Këshillit, në Gjykatën Kushtetuese është depozituar kërkesa datë 14.12.2023, e 1/5 së deputetëve me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, zgjidhjen e konflikteve të kompetencave ndërmjet Kuvendit, SPAK-ut e GJKKO-së, sa i takon kufizimit të lirisë së deputetit në çdo formë. Avokatët depozituan kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese në cilësinë e provës me qëllim që anëtarët e Këshillit të njihen me këtë fakt e për ta marrë në konsideratë në lidhje me vendimmarrjen.

Në parashtrimet e tyre i kërkuan Këshillit të pezullonte seancën me arsyen se Gjykata Kushtetuese do të merrte në shqyrtim kërkesën e 1/5 së deputetëve dhe se Këshilli duhet të priste vendimin e Gjykatës Kushtetuese, vendim që ndikon në këtë proces që kryen Këshilli. Kjo pasi, Prokuroria e Posacme, herën e parë kur ka kërkuar masën e sigurimit “detyrim paraqitje” dhe “ndalim për të udhëtuar jashtë shtetit” ndaj deputetit z.Sali Berisha, nuk i është drejtuar Kuvendit për të marrë autorizim sipas nenit 73/2 të Kushtetutës. Në rastin në shqyrtim, Prokuroria e Posacme ka paraqitur një kërkesë për autorizim Kuvendit për një masë sigurimi më të rëndë, por shqyrtimi i kësaj kërkesë nuk mund të kryhet pa u shqyrtuar çështja në Gjykatë Kushtetuese sepse shqyrtimi i kërimit për një masë më të rënduar lidhet me sqarimin e kushtetushmërisë së masave të para vendosur me vendim gjykate për z. Sali Berisha. Sipas avokatëve, Këshilli nuk mund ta riparojë dot këtë, dhe për këtë arsye kërkon shtyrjen dhe pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së SPAK deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Kjo kërkesë paraprake e avokatëve të z. Sali Berisha, u shqyrtua dhe trajtua nga Këshilli pa nisur shqyrtimi i kërkesës së Prokurorisë së Posacme dhe u vendos rrëzimi i saj, sipas arsyetimit që jepet më poshtë në këtë vendim.

Në lidhje me kërkesën e Prokurorisë së Posacme, objekt shqyrtimi nga ky Këshill, avokatët në mënyrë të përmbledhur parashtruan si vijon:

- **Lidhur me ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e kërkesës së Prokurorisë së Posacme**

Avokatët parashtruan se kërkesa për dhënien e autorizimit për arrestimin e zotit Berisha dhe arsytet janë vetëm politike dhe nuk kanë asnjë mbështetje dhe bazë ligjore, që të justifikojnë dhënien e autorizimit nga Kuvendi me pasojë arrestimin e zotit Berisha. Sipas tyre, SPAK ka pasur detyrimin që përpara se t'i hiqte lirinë me çfarëdolloj forme deputetit Sali Berisha, në rastin konkret nëpërmjet masave shtrënguese personale “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, t’i drejtohej Kuvendit për të marrë autorizim në përputhje me nenin 73, pika 2, të Kushtetutës.

Avokatët, duke iu referuar nenit 288, paragrafi 2, të K.Pr.Penale ku parashikohet se: “*Kërkesa për autorizim paraqitet kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në këtë Kod për kryerjen e veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ajo shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij.*”, pretenduan që organi i akuzës me mënyrën antikushtetuese sesi ka vepruar, ka gjetur “zgjdhjen” që të mos paraqesë prova në Kuvend, për të vërtetuar ekzistencën e supozuar të faktit penal, duke anashkaluar këtë kompetencë mjaft të rëndësishme të Kuvendit. Ata theksuan se përpara Kuvendit duhet të paraqiten prova dhe jo dokumente të tjera, qoftë këto edhe vendime gjykatash, pikërisht sepse filtri kushtetues i imunitetit si garanci për çdo deputet që të ushtrojë funksionet e tij, i pandikuar nga interferenca e pushteteve të tjera, i takon vetëm dhe ekskluzivisht Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas avokatëve mbrojtës, vendimet që shoqërojnë kërkesën për dhënien e autorizimit janë antikushtetuese për arsye sepse janë marrë në shkelje flagrante të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 73 të Kushtetutës parashikohet se “2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose **t’i hiqet liria në çfarëdolloj forme** apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.”

Ata theksuan se ky parashikim kushtetues është reflektuar në nenin **288 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se** “1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, **heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme**, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi.”, duke argumentuar se imuniteti lidhet me nevojën e dhënies së autorizimit paraprak nga ana e Kuvendit, *veçanërisht* në caktimin e masave të sigurimit që për vetë natyrën e tyre e kufizojnë ose heqin lirinë e deputetit nëse ai ndiqet penalisht, si edhe me rastet e nevojës së kryerjes së veprimeve hetimore penale, si të kontrollit personal dhe të banesës së deputetit që i nënshtrohet ndjekjes penale.

Po sipas mbrojtjes, kjo lloj garancie kushtetuese shtrihet dhe vepron vetëm gjatë periudhës kur *deputeti* ushtron mandatin e tij, pasi imuniteti nuk përbën privilegj personal, por garanci që deputetët dhe Kuvendi të ushtrojnë funksionin e tyre legjislativ dhe aktivitetin politik pa kurrfarë ndërhyrje të padrejtë dhe të paligjshme që mundet të vijnë nga pushtetet e tjera.

Avokatët mbrojtës pretenduan se Kushtetuta ka qenë e qartë kur citon “...ose t’i hiqet liria në çfarëdolloj forme”, duke e specifikuar dhe përforcuar këtë garanci për deputetin, duke u shprehur “**në çfarëdolloj forme**”.

Sipas tyre, nuk mundet të ngrihet asnjë pretendim apo aludim për ngatërresë mes termave “**heqje**” apo “**kufizim**” lirie. Në çdo rast, vetë Kushtetuta i ka barazuar këta dy terma në nenin 27, ku në paragrafin e parë citon “*Askujt nuk mund t’i hiqet liria...*” dhe në paragrafin e dytë, ku specifikon rastet përjashtimore të paragrafit të parë, citon “*Liria e personit nuk mund të kufizohet...*”

Mbrojtja theksoi se ky interpretim, është kaq i qartë saqë ka qenë evident për organin e akuzës dhe për Gjykatën në rastin e deputetit Saimir Tahiri, ku është kërkuar dhe është dhënë autorizim nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 104/2017 të datës 25.10.2017, përpara se të kërkohej caktimi i masave personale shtrënguese “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Pikërisht ky diferencim i dy rasteve absolutisht identike **shkel nenin 18, paragrafi 1 i Kushtetutës**, ku citohet “**Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.**”

Në vijim avokatët pretenduan se, duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë jo vetëm me një deputet të Kuvendit të Shqipërisë, por me liderin e opozitës në vend dhe shkelja e Kushtetutës, në kushtet e një praktike të mëparshme, rezulton e qëllimshme, jemi në kushtet e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, sipas nenit 18, paragrafi 2, të Kushtetutës.

Ata argumentuan se, në të njëjtën frymë, liria e lëvizjes është një nga liritë themelore të individit, e garantuar në Kushtetutën e RSH-së, dhe ndalimi i lëvizjes së individit jashtë shtetit është një formë e heqjes së lirisë së tij, pavarësisht se në intensitet mund të mos jetë në të njëjtin nivel apo shkallë me burgosjen. Pikërisht në këtë frymë, Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 38, pika 2, sanksionon “*Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit*”. Neni 73, pika 2, e saj përcakton se “*Deputetit nuk mund t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme pa autorizim të Kuvendit të Shqipërisë*”. Liria e lëvizjes jashtë shtetit është një nga liritë kryesore që ligjvënësi i konsideron kaq shumë të rëndësishme, saqë i garanton me Kushtetutë dhe heqja apo kufizimi i njëres prej tyre, në rastin e një deputeti, mund të bëhet vetëm duke respektuar nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, pra pas marrjes së autorizimit të Kuvendit. Faza “në çfarëdo lloj forme” qartazi u referohet masave që kufizojnë lirinë e individit në forma dhe intensitet të ndryshëm, e ku përfshihet edhe kufizimi i lirisë së lëvizjes.

Avokatët në parashtrimet e tyre pretenduan se vendimet e sipërcituara janë marrë në shkelje të hapur të ligjit themelor të vendit dhe konventave ndërkombëtare të lirive dhe të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Ata theksuan se antikushtetushmëria e procesit ndaj caktimit të masave të sigurimit personal është kontestuar ligjërisht me të gjitha mjetet juridike deri në momentin aktual.

Avokatët sqaruan se gjatë gjykimit në shkallë të parë është paraqitur një kërkesë me objekt “*Dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese për interpretimin e nenit 73, pika 2, konkretisht të shprehjes “ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme”*”, kërkesë e rrëzuar nga gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku), në shkelje procedurale, pasi e ka rrëzuar këtë kërkesë ndërkohë që kishte ende të pashqyrtuar një kërkesë për përjashtimin e gjyqtares. Sipas tyre, për këtë pretendim asnjë fjalë e vetme nuk gjendet në arsyetimin e Gjykatës së Apelit.

Avokatët parashtruan se janë në dijeni se 1/5 e deputetëve (firmosur nga 30 deputetë) të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke i kërkuar konstatimin e antikushtetushmërisë së heqjes së lirisë së zotit Berisha, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet masave shtrënguese personale “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*” dhe pritet që Gjykata Kushtetuese të bëjë interpretimin përfundimtar, si i vetmi institucion që ka këtë kompetencë sipas Kushtetutës.

Po sipas mbrojtjes, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga 1/5 e deputetëve, përveç interpretimit përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, është kërkuar edhe pezullimi i masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit Sali Berisha, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet me vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje. Gjykimi i kësaj kërkesë si masë provizore ka prioritet, kërkon një gjykim brenda një afati të shpejtë dhe ka efekt të menjëhershëm. Në këtë aspekt, ata pretenduan se, kjo procedurë parlamentare duhet të pezullohet dhe të pritet gjykimi kushtetues, pasi çështja është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Avokatët pretenduan se kjo kërkesë për pezullimin e kësaj procedure parlamentare është e bazuar dhe e mbështetur edhe në shmangien eventuale të një interpretimi të ndryshëm të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese nga ana tjetër.

- ***Në lidhje me moszbatimin e vendimeve të gjykatës.***

Avokatët parashtruan se, pavarësisht pretendimeve të SPAK-ut për moszbatimin e masës shtrënguese personale “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, kjo masë asnjëherë nuk i është komunikuar, dhe për pasojë nuk është zbatuar në përputhje me nenin 246 të Kodit të Procedurës Penale. Në parashtrimet e tyre sqaruan se nuk është zbatuar në asnjë rast, në mënyrë të rregullt njoftimi sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale dhe më konkretisht të normuar nga neni 140 i Kodit të Procedurës Penale “Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë”.

Sipas mbrojtjes, në kuadër të rregullimeve të kësaj dispozite rezulton se në rastin konkret:

1. Në asnjë rast vendimi nuk i është dorëzuar personalisht deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Sali Berisha.
2. Në asnjë rast vendimi nuk i është dorëzuar një personi që bashkëjeton me të ose një personi që punon me të, i cili të marrë përsipër njoftimin dhe të tregohen gjeneralitetet e tij dhe lidhjen që ka me zotin Berisha.
3. Në asnjë rast nuk është kërkuar për zotin Berisha në vende të tjera apo për ndonjë banesë të përkohshme.
4. Në asnjë rast nuk ekziston një depozitim në qendrën administrative të lagjes ku banon ose punon dhe për këtë depozitim të njoftohet zoti Berisha me letër rekomande me lajmërim marrje, sikurse e kërkon paragrafi 5 i nenit 140 të KPrP. Ky paragraf e kushtëzon rrjedhjen e efekteve të njoftimit nga marrja e rekomandesë.

Po sipas mbrojtjes, këto shkelje procedurale, për sa i përket njoftimit të vendimit për zotit Berisha, e bëjnë absolutisht të pavlefshëm të gjithë procesin dhe për rrjedhojë edhe vendimet e depozituara si dokumente shoqëruese me kërkesën për dhënien e autorizimit nga ana e SPAK-ut (neni 128/a paragrafi 1, pika c, i K.Pr.Penale “*Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit, viktimës ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme*”). Këto fakte, sipas avokatëve mbrojtës, provojnë gjithashtu edhe të kundërtën e asaj që pretendohet në këtë kërkesë nga ana e SPAK-ut, që do të thotë se këto masa sigurimi shtrënguese personale jo vetëm që nuk janë shkelur nga zoti Berisha, por as nuk janë zbatuar ndonjëherë.

Avokatët parashtruan se, nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se në cilësinë e mbrojtësit të zotit Berisha kanë patur dijeni dhe kanë ndjekur procesin, pasi ligji procedural penal për efekte të zbatimit të masave të sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” nuk mund të zëvendësojë detyrimin për njoftimin personalisht të personit kundrejt të cilit janë caktuar masat e sigurimit. Në këtë aspekt, ata sqaruan se është më se e qartë se pretendimi i SPAK-ut në relacionin drejtuar Kuvendit për dhënien e autorizimit për arrestimin e zotit Berisha, nëpërmjet masës së sigurimit personal shtrëngues, është i pambështetur dhe i pabazuar.

- ***Në lidhje me vendimmarrjen e GJKKO-së***

Avokatët arsyetuan se vendimet e GJKKO-së janë absolutisht të pavlefshme edhe për faktin se në rastin konkret nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete (neni 128/a, paragrafi 1, pika a, KPrP). Sipas tyre, Gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) nuk ka qenë në kushtet për të qenë gjyqtare në rastin konkret, pasi, siç rezulton nga provat që ne disponojmë, kjo gjyqtare është përjashtuar nga detyra e gjyqtares në shkurt të vitit 1996 për paaftësi në përmbushjen e detyrës nga KLD-ja e kryesuar nga zoti Berisha, në cilësinë e Presidentit të Republikës në atë kohë.

Po sipas mbrojtjes, kjo gjyqtare kishte detyrimin për të hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje për caktimin e masave të sigurimit personal shtrënguese ndaj zotit Berisha, në përputhje me nenin 17 të KPrP. Ata pretenduan se, zoti Berisha nuk është gjykuar nga gjykatë e pavarur dhe paanshme në kuadër të një procesi të rregullt ligjor.

Avokatët parashtruan se, pikërisht rrjedhojë e gjykimit nga një gjykatë, e cila nuk ka qenë e pavarur dhe paanshme, është lejimi i shkeljeve të rënda procedurale që kanë lidhje me shkeljen e së drejtës për realizimin e një mbrojtjeje efektive, duke u penguar mbrojtësit me prokurë për të realizuar këtë mbrojtje dhe duke iu ngarkuar realizimi thjesht i prezencës së një mbrojtësi vetëm formalisht, në shkelje të Kodit Etik të Avokatit dhe të ligjit nr. 55/2018 “*Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë*”, dhënien e vendimit ndërkohë që ende nuk ishte shqyrtuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtares dhe shkelje të tjera të rënda procedurale, si moszbardhja dhe arsyetimi i vendimit brenda 48 orëve sipas kërkesës së nenit 248, pika 2, të KPrP, shkelje e pranuar edhe nga vetë Gjykata dhe SPAK-u, por që pretenduan se nuk ka pasojë ligjore.

Sipas avokatëve, faktet e paraqitura prej tyre vërtetojnë në mënyrë të pakontestueshme se dokumentet e paraqitura dhe që shoqërojnë kërkesën për dhënien e autorizimit janë absolutisht të pavlefshme dhe antikushtetuese.

Ata referuan se neni 288, paragrafi 2, i KPrP kërkon një relacion të arsytuar të shoqëruar me prova që mbështesin këtë kërkesë. Në kërkesën për dhënien e autorizimit fare përciptazi SPAK i referohet faktit të pretenduar në mënyrë më të shkurtër sesa telegrafikisht. Konstatohet lehtësisht në këtë përshkrim të shkurtër se SPAK pretendon që *“Konkretisht, nga hetimet, vlerësohet se është krijuar dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova se personi nën hetim Sali Berisha, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, përgjatë periudhës kohore që shtrihet që nga viti 2005 e në vijim, ka kryer veprime konkrete, aktive, në miratim ligjesh apo aktesh nënligjore, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familje ish-pronare, me qëllim kthimin dhe në vijim shfrytëzimin si troje ndërtimore të territoreve ku janë shtrirë ish Klubi Shumësportësh Partizani dhe ish Klubi i Futbollit Partizani, ku përfitues i drejtpërdrejtë, ndër të tjerë, rezultonte të ishte bashkëshorti i vajzës së tij, shtetasi Jamarbër Malltezi.”*

Po sipas avokatëve, nga ky përshkrim rezulton qartë se zoti Berisha ndiqet penalisht për aktivitetin e tij politik, në kohën që i referohet SPAK e deri në ditët e sotme. Për më tepër, sqaruan ata, asnjë nga aktet ligjore e nënligjore të cituara nuk janë akte nominale, që lidhen me ndonjë familje specifike apo objekt specifik, por akte rregulluese të përgjithshme, që kanë ofruar regjimin rregullues për të gjithë shtetasit shqiptarë.

Në kërkesën për dhënien e autorizimit citohet se përfitimi i parregullt konsiston në ndryshimin e destinacionit të zonave nga sportive në të banimit, pavarësisht interesit publik që ekziston në lidhje me nevojën e ekzistencës së ambienteve sportive, gjë që ka çuar në kryerje ndërtimesh. Sipas avokatëve, SPAK ka fshehur provat që vërtetojnë se ky ndryshim destinacioni është kryer nga zoti Rama, në atë kohë kryetar i Bashkisë Tiranë.

Avokatët në fjalën e tyre pretenduan se SPAK-u ka shkelur detyrimin që buron nga neni 8/a paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale, i cili e detyron organin e akuzës të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij. SPAK-u, përveçse nuk ka sjellë asnjë provë në Kuvend, këto prova dhe shumë të tjera i ka fshehur goftë edhe në rrugën antikushtetuese që ka zgjedhur, pra për të shkuar direkt në Gjykatë për të kërkuar masat e sigurimit ndaj deputetit dhe liderit të opozitës, zotit Sali Berisha.

Gjithashtu, avokatët parashtruan edhe pretendime në lidhje me akuzën për të cilën SPAK-u ka person nën hetim zotin Sali Berisha. Sipas avokatëve nuk ka asnjë fakt se kush e ka dhënë shpërblimin e parregullt, në mënyrë që formalisht të ngrihet dyshimi për veprën penale të korrupsionit pasiv (dikush e jep, dikush e merr).

Po sipas mbrojtjes, SPAK-u nuk thotë asnjë fjalë të vetme se nga vjen përfitimi i parregullt, as në këtë kërkesë të Kuvendit dhe as në gjykatë.

Avokatët pretenduan se jemi përpara veprës *penale të korrupsionit pasiv vetëm* nëse ekziston dijenia që marrja apo pranimi është në korrelacion me dhënien apo premtimin e një të treti. Një premtim i thjeshtë për përfitime në të ardhmen, pa iu drejtuar konkretisht funksionarit dhe pa u pranuar nga ana e tij, duke u ndërgjegjësuar dhe pasur dijeninë rreth saj, nuk do të mjaftonte për konfigurimin e kësaj vepre penale.

Sipas avokatëve mbrojtës, SPAK-u duhet gjithashtu t'i bëjë me dije Kuvendit nëse gjatë kësaj periudhe janë rënduar rrethanat e sigurimit dhe nëse ka prova që të justifikojë se në rastin konkret ka rrezik të dëmtohen provat ose nëse ka rrezik që deputeti dhe lideri i opozitës t'i shmanget hetimit.

Mbrojtja theksoi se në tre vjet hetime dhe nga dita që ka bërë kërkesë për caktimin e masave të sigurimit ndaj zotit Berisha e deri më sot, nuk e ka thirrur asnjëherë zotin Berisha për t'u pyetur. Sipas avokatëve, duket qartë se i vetmi synim është arrestimi sa më i shpejtë i zotit Berisha për ta penguar në funksionin e tij politik si deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe si lider i opozitës në momentin kur zoti Berisha dhe opozita kanë përshkallëzuar aksionin opozitar.

Në përfundim të fjalës së tyre i kërkuan Këshillit rishikimin edhe një herë të vendimmarrjes për pezullimin e kësaj procedure parlamentare deri në vendimmarrjen e gjykatës, duke pasur tashmë në konsideratë edhe bazën ligjore, nenin 66 të Kodit të Procedurës Administrative

Pas parashtrimeve, avokatët iu përgjigjën edhe pyetjeve të deputetëve, si dhe dorëzuan si prova disa dokumenta të fiksuara në procesverbalin e mbledhjes.

IV. VLERËSIMI I KËSHILLIT PËR RREGULLOREN, MANDATET DHE IMUNITETIN

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, pasi dëgjoi Prokurorin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Z. Arben Kraja, në cilësinë e tij si prokuror i çështjes si dhe prokuroren Znj. Enkelejda Millonaj, avokatët e deputetit z. Sali Berisha, Z. Genc Gjokutaj dhe Z. Sokol Mëngjesi, pasi u njoh me relacionin dhe provat shoqëruese të kërkesës, parashtrimet e mbrojtjes për to, diskutoi në lidhje me raportin rekomandues që i dërgon seancës plenare.

Këshilli me unanimitet vendosi t'i propozojë seancës plenare miratimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënie autorizimi për arrestim/heqje lirie për deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Deputeti Enkelejd Alibeaj, anëtar i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin cmoi të vecojë mendimin e tij nga ai i shumicës parlamentare, duke paraqitur një raport rekomandues më vete.

Ne deputetët e shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin çmojmë të trajtojmë në këtë raport rëndësinë e parimeve të shtetit të së drejtës që duhen respektuar në procese të tilla, në funksion të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Fillimisht ky Këshill vlerëson të evidentojë në këtë raport se, nga ana e avokatëve mbrojtës të deputetit Sali Berisha u paraqit një kërkesë paraprake, nëpërmjet së cilës kërkuan pezullimin e procedurës parlamentare, për shqyrtimin kërkesës së SPAK për dhënien e autorizimit për

arrestim/heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Sali Berisha nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit nga ajo e “*Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale, në atë të arrestit në burg/arrest në shtëpi, parashikuar nga nenet 238/237 të K.Pr.Penale, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehej mbi kërkesën e 1/5 së deputetëve të opozitës parlamentare.

Konkretisht, avokatët mbrojtës parashtruan se, në momentin që zhvillohet kjo seancë në Këshill, në Gjykatën Kushtetuese, është depozituar kërkesa e 1/5 së deputetëve të Kuvendit Republikës së Shqipërisë, me nr.1 Prot., datë 14.12.2023, me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 73 pika 2 të Kushtetutes, zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe SPAK e GJKKO, përsa i takon çështjes së heqjes dhe/ose kufizimit të lirisë të deputetit të Kuvendit në çdo formë, pa kërkuar dhe pa marrë paraprakisht autorizimin nga Kuvendi.

Po sipas mbrojtjes, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga 1/5 e deputetëve, përveç interpretimit përfundimtar të nenit 73 pika 2 të Kushtetutës, është kërkuar edhe pezullimi i masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj deputetit Sali Berisha, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet me vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje. Gjykimi i kësaj kërkesë si masë provizore ka prioritet, kërkon një gjykim të brenda një afati të shpejtë dhe ka efekt të menjshëm.

Në këtë aspekt, mbrojtja ka kërkuar që kjo procedurë parlamentare duhet të pezullohet dhe të pritet gjykimi kushtetues, tashmë i inicuar. Kjo kërkesë për pezullimin e kësaj procedure parlamentare, sipas tyre, është e bazuar dhe mbështetur edhe në shmangien eventuale të një interpretimi të ndryshëm të nenit 73 pika 2 të Kushtetutës nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga njëra anë, dhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese nga ana tjetër.

Sipas mbrojtjes, ky fakt është determinant për vendimmarrjen e Këshillit lidhur me objektin e kërkesës së SPAK.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, cmoi e vlerësoi se kërkesa e sipërmendur, për pezullimin e procedurës parlamentare, për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestim/heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z.Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurisë, është e pambështetur në ligj, ndaj unanimisht e rrëzoi atë, për këto arsye:

Së pari, në respekt të procedurës, si dhe parimit të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, kërkesa paraprake e paraqitur nga mbrojtja, për pezullimin e procedurës parlamentare për shqyrtimin e një kërkesë nga ana e SPAK, për dhënien e autorizimit për arrestim/heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Sali Berisha, është një kërkesë e cila shqyrtohet në bazë të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.

Në rastin konkret, rezulton se nuk ka asnjë dispozitë ligjore, mbi të cilën të mbështetet kërkesa paraprake e mbrojtjes, për të pezulluar procedurën parlamentare.

Gjithashtu, kërkesa e paraqitur nga ana e SPAK në këtë Këshill nuk ka lidhje me çështjen që ka në shqyrtim Gjykata Kushtetuese, pasi jemi para një situatë të ndryshme nga ajo për të cilën është depozituar kërkesa në Gjykatë Kushtetuese, ndaj shqyrtimi i kësaj kërkesë të SPAK, nuk përbën pengesë për vijimin e procedurës parlamentare.

Së dyti, duhet theksuar se në kërkesën e depozituar në Gjykatën Kushtetuese nga 1/5 e deputetëve me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 73 pika 2 të Kushtetutes, nuk është bërë asnjë kërkesë lidhur me pezullimin e procedurës parlamentare për shqyrtimin kërkesës së SPAK për dhënien e autorizimit për arrestim/heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Sali Berisha nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit nga ajo e “*Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale, në atë të arresitit në burg/arrest në shtëpi, parashikuar nga nenet 238/237 të K.Pr.Penale.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin çmon të evidentojë edhe faktin se, rezulton e provuar se procedura parlamentare për dhënien e autorizimit për arrestim/heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Sali Berisha ka filluar më datë 12.12.2023. Ndërkohë kërkesa e 1/5 së deputetëve me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 73 pika 2 të Kushtetutes, është depozituar në Gjykatën Kushtetuese në datën 14.12.2023, pra dy ditë më vonë.

Deri më sot rezulton se, nuk ka asnjë vendim të Gjykatës Kushtetuese për të pezulluar këtë procedurë parlamentare për dhënien e autorizimit për arrestim/heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Sali Berisha. Këshilli vlerëson se mbrojtja mund të ndjekë mjetet ligjore për të kundërshtuar këtë procedurë parlamentare.

Sa më lart, në kushtet kur nuk ekziston asnjë dispozitë kushtetuese dhe ligjore, asnjë situatë faktike apo një vendim përkatës që mund të detyrojë këtë Këshill të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së ardhur nga SPAK, atëherë arrihet në përfundimin se procedura parlamentare duhet vijojë e si rrjedhim, kërkesa e mbrojtjes për pezullimin e saj duhet rrëzuar si e pambështetur në ligj.

Mbrojtja parashtroi pretendimin se kërkesa për pezullim të procedurës parlamentare bazohet në nenin 66 të K.Pr.Administrative, sipas të cilit, nëse organi publik që zhvillon procedurën, përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palët në lidhje me këtë.”

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin çmon e vlerëson se në rastin konkret nuk ka vend aplikimi i dispozitave të K.Pr.Administrative, për shkak se procedura parlamentare ka një rregullim të posaçëm, që buron nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Autonomia e veprimtarisë parlamentare, ashtu si autonomia e procedimit gjyqësor, nuk përfshihen tek rregullat e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative. Pikërisht, rregullat dhe organet e posacme e bëjnë pushtetin gjyqësor dhe atë legjislativ të vecantë, pasi në të kundërt, do të ishte mjaftueshëm të ekzistonte vetëm një Kod të Procedurave Administrative.

Kodi i Procedurave Administrative zbatohet nga organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative. Ndërkohë që Kuvendi i Shqipërisë si organ kushtetues e organizon veprimtarinë e tij nëpërmjet një akti normativ, që është Rregullorja e Kuvendit, e cila varet drejtpërdrejt vetëm prej normave kushtetuese dhe miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 75/2 i Kushtetutës).

Qasja e mësipërme bazohet dhe në jurisprudencën kushtetuese të krahasuar, Kështu, Gjykata Kushtetuese e Italisë në vendimin e saj nr. 379, datë 2.11.1996 (ITA-1996-3-010), ndër të tjera ka mbajtur qëndrimin se *“Në rastin në fjalë, Gjykata Kushtetuese konfirmoi se veprimtaria e deputetëve në fjalë, të vlerësuara nga gjykata si të natyrës penale, duhet të konsiderohen – pasi ato binin tërësisht në objektin e rregullores parlamentare – që të mos jenë objekt i procedurave të ndryshme nga ato të parashikuara në rregulloren e dy dhomave parlamentare”*. Sic mund të konstatohet nga ky pasazh, çështje të tilla janë më natyrë penale dhe procedurat që ndjekin organet legjislative, rregullohen nga rregulloret e tyre të brëndshme. Pra, e thënë ndryshe, jemi përpara fushës së të drejtës kushtetuese dhe asaj penale, kur nuk ka vend për aplikimin e Kodit të Procedurave Administrative.

Në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posacme:

Para Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin është paraqitur për shqyrtim kërkesa e Prokurorisë së Posacme për dhënien e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit, Z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit nga ajo e *“Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”* parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe *“Ndalimi i daljes jashtë shtetit”*, parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale, në atë të arrestit në burg/arrest në shtëpi, parashikuar nga nenet 238/237 të K.Pr.Penale.

Në kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar parashtrohet se personi nën hetim plotëson kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe në bazë të akteve që shoqërojnë kërkesën për Prokurorinë e Posaçme ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të Kodit të Procedurës Penale se personi nën hetim Sali Berisha në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga ligji procedural penal në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij duke mos u paraqitur para oficerit të Policisë Gjyqësore.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, çmon të mbajë parasysh në shqyrtimin e kërkesës, faktin se ndryshimet që iu bënë Kushtetutës nëpërmjet ligjit nr.88/2012, sa i takon

kufizimit të imunitetit për subjektet e parashikuara në Kushtetutë, janë një premisë për fuqizimin e shtetit të së drejtës dhe luftën pa kompromis ndaj fenomeneve kriminale, pavarësisht rangut të zyrtarëve që dyshohet se kryejnë veprat penale.

Ndryshe nga sa parashikohej nga Kushtetuta e vitit 1998, me konsensusin e të gjitha partive politike, Kuvendi i Shqipërisë hodhi një hap të matur dhe të rëndësishëm përpara në garantimin e funksionalitetit të plotë të shtetit të së drejtës në vendin tonë. Nëse deri në vitin 2012, organi procedues as nuk mund të niste dhe nuk mund të kryente asnjë veprim procedural ndaj një personi që gëzonte imunitet kushtetues, i dyshuar për kryerjen e një vepre penale, me ndryshimet në fjalë, ky imunitet u kufizua vetëm në rastet kur kërkohej arrestimi, heqja e lirisë (ndalimi) apo kontrolli personal apo i banesës.

Edhe në rastin në shqyrtim, Prokuroria e Posaçme, si organ procedues në ushtrim të funksionit kushtetues për ndjekjen penale, ka rregjistruar një procedim penal dhe deputetin z. Sali Berisha e ka cilësuar si person nën hetim, si dhe ka kryer çdo veprim procedural që çmon të nevojshëm në përmbushje të objektivit primar, garantimit dhe dhënies së drejtësisë në një shtet, ku ligji është i barabartë për të gjithë shtetasit.

Në opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2006)005 (*mars 2006*) në lidhje me procedurat për kufizimin e imunitetit parlamentar dhe kushtet për dhënies së autorizimit për ndjekjen penale parashtrohet se: *“E drejta e Parlamenteve për të hequr imunitetin e anëtarëve të tyre është pjesë e padiskutueshme e traditës parlamentare evropiane. Objektivi kryesor i dispozitave që garantojnë imunitetin parlamentar është mbrojtja e vetë Parlamentit dhe në mënyrë të veçantë e funksionimit të duhur të tij. Imuniteti parlamentar nuk është një privilegj personal i secilit prej anëtarëve të Parlamentit”*.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin vlerëson se është pikërisht kjo fryma dhe standarti më i lartë që do të duhet të mbahet parasysh dhe të vlerësohet sa herë që bazuar në dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, organi që me Kushtetutë ka tagrin e ushtrimit të ndjekjes penale, Prokuroria e Posaçme në rastin konkret, i drejtohet parlamentit për të kërkuar autorizimin.

Në raportin e tij CDL-AD (2014)011 (*maj 2014*), për fushën e veprimit dhe heqjen e imunitetit parlamentar të hartuar bazuar në kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Komisioni i Venecias argumenton se: *“Komisioni i Venecias vlerëson për më tepër që organi parlamentar që shqyrton kërkesën për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes si e tillë. Në veçanti, ky organ nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës apo të bazueshmërinë së procedimit penal.”*

Nisur nga ky qëndrim i Komisionit të Venecias, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në rastin konkret nuk mund të marrë në shqyrtim bazueshmërinë në prova dhe fakte të kërkesës së paraqitur nga ana e organit procedues. Kjo pasi në rast të kundërt, Kuvendi i Shqipërisë do të cënonte një tjetër parim të rëndësishëm të shtetit të së drejtës, siç është ai i ndarjes së pushteteve.

Vlerësimin në rast se janë ose jo kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi personal apo kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, e bën sistemi gjyqësor nëpërmjet organit të tij, gjykatës, bazuar në parashikimet e posacme të Kodit të Procedurës Penale, neni 244 e vijues. Është vetëm gjykata, organi i vetëm, që mund të marrë në shqyrtim, të cmojë dhe në fund të disponojë në lidhje me kërkesat e organit të prokurorisë gjatë hetimeve paraprake, në rast se ato i gjen eventualisht të mbështetura në prova dhe në ligj.

Është gjykata ajo që garanton respektimin e të drejtave të njeriut në gjithë hallkat e procesit penal, procesin e rregullt ligjor, garancitë procedurale, kushtet dhe kriteret që parashikohen në ligjin procedural, etj si dhe zbatimin e parimit të proporcionalitetit të masës së sigurimit me kërkesat dhe faktet që i paraqiten për gjykim. Organi i akuzës ka detyrimin të respektojë e zbatojë garancitë procedurale dhe të drejtat e njeriut në proceset hetimore, pasi çdo cenim i këtyre garancive, jo vetëm që mund të konstatohet si shkelje nga gjykata, por rrezikon të dëmtojë dhe vetë rezultatet e punës së organit të akuzës në shërbim të interesit publik, duke ndikuar dhe në kredibilitetin e vetë institucionit dhe uljen e besimit të publikut te drejtësia.

Në raportin CDL-AD (2014)011 (*maj 2014*), Komisionit i Venecias ka trajtuar dhe kujdesin që duhet treguar në shqyrtimin e kërkesave të tilla për dhënie autorizimi, referuar interferencave të mundshme politike. Në këtë raport është argumentuar se: *“Komisioni i Venecias në përgjithësi vlerëson se duhet të ekzistojnë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet, kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht.”* Kur trajtohet çështja e motivimit të akuzave nga shkaqe që nuk janë të ligjshme, nënkuptohen ndërhyrje politike apo qëndrime/ndikime të natyrave të tjera që nuk përkojnë me realizimin e funksioneve të ndjekjes penale sipas parimeve të shtetit të së drejtës, por me ndikime të padrejta që cenojnë pavarësinë, paanësinë dhe profesionalizmin e organeve të drejtësisë.

Natyra e procedurës parlamentare në Kuvend në këto raste, fillimisht në Këshill është e një natyre jo politike, por garantuese që parimet e shtetit të së drejtës dhe parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve të mos cenohet. Këto procedura duhet të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme të ligjit procedural penal, përfshirë të drejtën e palëve për t’u dëgjuar. Ato duhet të jenë të kuptueshme, të qarta dhe të parashikueshme. Procedurat duhet të respektojnë në çdo rast parimin e prezumimit të pafajësisë, siç është e mbrojtur dhe nga KEDNJ dhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në këtë procedurë Këshilli vepron në mbështetje të nenit 73 të Kushtetutës dhe 288 të K.Procedurës Penale, mbikqyr garancitë që respektojnë liritë, të drejtat dhe sigurojnë që ndaj deputetit të mos kryhet arrestim arbitrar.

Bazuar në këto standarde, në shqyrtime të këtij lloji:

- i) Kuvendi ka kompetencë të vlerësojë nëse plotësohen kushtet ligjore për të dhënë autorizimin për marrjen e një mase të sigurimit personal siç është arresti në burg apo në shtëpi, heqje lirie në çfarëdolloj forme, kontroll personal dhe të banesës së deputetit;

- ii) Nëse plotësohen apo jo kushtet, Kuvendi duhet të bazohet në gjykimin e vet, duke iu referuar relacionit të organit të akuzës dhe provave që mbështesin këtë relacion;
- iii) Kuvendi, nuk bën vlerësimin e provave, por vlerësimin e kushteve dhe rrethanave për të krijuar bindjen se ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara se deputeti ka kryer një vepër penale;
- iv) Nëse kërkesa është bërë nën ndikime politike apo të natyrave të tjera të paligjshme.

Nga pikëpamja formale: Nisur nga këto konsiderata të përgjithshme, në anëtarët e Këshillit, në analizë të akteve të marra në shqyrtim vlerësojmë se nga pikëpamja formale, kërkesa e organit të akuzës, Prokurorisë së Posaçme, ndaj deputetit Z. Sali Berisha, është në përputhje me kërkesat ligjore. Prokuroria e Posaçme legjitimohet të paraqesë kërkesën në shqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo kërkesë plotëson kriteret e nenit 73, pika 2 e Kushtetutës, pasi bëhet për ato shkaqe që parashikohen nga kjo dispozitë. Kërkesa është në përputhje me nenin 288, pika 1 dhe 2 e Kodit të Procedurës Penale, pasi është shoqëruar me relacionin shpjegues dhe provat përkatëse, sipas kërkesave në këtë dispozitë.

Nga pikëpamja substanciale: detyrë e Këshillit është të vlerësojë nëse kërkesa e organit të akuzës ndaj deputetit Z. Sali Berisha, bazohet në kërkesat standarde që ka Kodi i Procedurës Penale në lidhje me një proces penal të rregullt, apo kërkesa e organit të akuzës është e motivuar apo ka sfond politik, apo është e motivuar nga shkaqe të tjera që nuk kanë lidhje me procesin e rregullt penal.

Në gjykimin e këtij Këshilli në analizën e kërkesës, mbahet parasysh se interesi mbizotërues është drejtësia dhe dhënia e të gjitha mundësive organit procedues për të hetuar e për të zbuluar deri në fund të vërtetën, por në këto raste detyrë e Kuvendit është dhe respektimi i disa standarteve kushtetuese për garantimin e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtave të njeriut.

Kjo kushtëzohet nga fakti se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është, ndër të tjera, për dhënien e autorizimit për arrestim/heqje lirie të deputetit Z. Sali Berisha, që përbën një masë ekstreme, e cila lidhet me një të drejtë themelore të njeriut siç është liria personit, e mbrojtur nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 5) dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 27), e cila kufizohet vetëm kur:

- Ka dyshime të arsyeshme dhe të bazuara se personi ka kryer një vepër penale;
- Duhet të parandalohet për një vepër penale që personi mund ta kryejë nëse nuk i kufizohet liria;
- Ekziston rreziku se personi do largohet.

Raporti i CDL-AD(2014)01 i Komisionit të Venecias, përshkruan disa kritere që në fakt lidhen qartazi jo me mundësinë për të lejuar arrestimin e një deputeti, por me nevojën për të lejuar procedimin penal me qëllim që drejtësia të mund të veprojë ndaj të gjithë shtetasve në mënyrë të barabartë. Në këtë raport, ndër të tjera theksohet se duhet vlerësuar nëse:

- Kërkesa për të hequr imunitetin është mbështetur në argumente serioze, të sinqerta dhe të ndershme;
- anëtari (deputeti) është kapur në flagrancë;
- shkelja e pretenduar është e një natyre shumë serioze;
- kërkesa lidhet me një sjellje kriminale që nuk ka të bëjë me aktivitetin parlamentar, por lidhet me akte të kryera në lidhje me të tjera funksione personale ose profesionale;
- procedimi duhet lejuar me qëllim për të mos penguar drejtësinë;
- procedimi duhet lejuar me qëllim që të ruajë autoritetin dhe legjitimitetin e parlamentit;
- anëtari kërkon vetë që imuniteti të hiqet.

Në analizë të kërkesës, relacionit e provave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme, rezulton se, ky organ ka rregjistruar procedimin penal nr. 287 të vitit 2020, për veprat penale: Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në datën 2.10.2023, në kuadër të këtij procedimi penal, është vendosur, ndër të tjera, regjistrimi i emrit të personit nën hetim Sali Berisha, i dyshuar se ka kryer veprën penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 -25 i Kodit Penal. Kjo dispozitë parashikon se kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhur vendor, për të kryer apo moskryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim ose katër deri në dymbëdhjetë vjet. Konkretisht nga hetimi vlerësohet se është krijuar dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova se personi nën hetim Sali Berisha, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, përgjatë periudhës kohore që shtrihet që nga viti 2005 e në vijim, ka kryer veprime konkrete, aktive, me miratim ligjesh, apo akte nënligjore, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familje ish-pronare, me qëllim kthimin dhe në vijim shfrytëzimin si troje ndërtimore të territoreve ku janë shtrirë ish-Klubi shumësportësh “Partizani” dhe ish-Klubi i Futbollit “Partizani”, ku përfitues i drejtpërdrejtë ndër të tjerë rezultonte të ishte bashkëshorti i vajzës së tij, shtetasi Jamarbër Malltezi. Sipas organit të akuzës, nga ana e shtetasit Sali Berisha janë kryer veprime aktive, në cilësinë si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e kontrolleve administrative me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave konkretë për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin përfundimin e procesit të privatizimit, në favor, ndër të tjera, të shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshorti i vajzës së tij. Sipas organit të akuzës: nga ana e shtetasit Sali Berisha janë kryer veprime aktive, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, në vendosjen në dispozicion të shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshortit të vajzës së tij, të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të privatizimit të pronës shtetërore në favor të dhëndrit të tij; Përfitime të parregullta llogariten në shumën 5.420,345 euro; Vepra penale e korrupsionit pasiv, e cila ka në vetvete qëllimin e përfitimit për vete apo dhe për persona të tjerë, në rastin konkret është evidentuar pikërisht se ky përfitim është marrë nga personi nën hetim Jamarbër Malltezi.

Sipas relacionit dhe parashtrimeve të Prokurorisë së Posaçme në Këshill, ekziston dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova se deputeti e ka kryer veprën penale dhe për nevoja të hetimit të

mëtejshëm kërkohet dhënia e autorizimit për masën që kërkohet në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme drejtuar Kuvendit. Sa sipër, janë verifikuar me vendime gjyqësore sic pasqyrohen në aktet e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme bashkëlidhur kërkesës dhe relacionit drejtuar Kuvendit, dhe konkretisht vendimet gjyqësore nr. 112 date 20 .10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, nr. 117, datë 26.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, nr. 56, datë 21.11.2023.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, nuk rezulton që kërkesa të jetë bërë në kushtet e një ndikimi politik apo të një natyre/ndërhyrje tjetër të padrejtë që të bjerë ndesh me interesat e drejtësisë. Në mënyrë të përmbledhur, të pyetur nga anëtarët e Këshillit, nëse organi i akuzës është ndërë i ndikuar nga ndonjë faktor për ushtrimin normal të funksioneve të veta, nëse deputeti është vënë në dispozicion të drejtësisë apo e ka penguar hetimin, nëse institucionet shtetërore apo subjekte të tjera e kanë penguar atë të realizojë detyrat e veta, përfaqësuesit e organit të akuzës u përgjigjën se referuar procesverbaleve të konstatimit të mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore/hetuesi në datat 06.11.2023, 20.11.2023, 04.12.2023, konstatohet se personi nën hetimin Sali Berisha nuk ka zbatuar vendimin e gjykatës duke mos u paraqitur asnjëherë para Policisë Gjyqësore dhe se organi i akuzës nuk ndihet nën presion për ushtrimin e funksioneve të veta, të cilat po i ushtron sipas ligjit dhe nuk ka asnjë sfond politik në punën e vet.

Edhe nëse i referohemi jurisprudencës së krahasuar, rezulton se Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen C-200/07, C-201/07, datë 21.10.2008 (ECJ-2010-2-012), mbajti qendrimin se *“Një imunitet i tillë, në masën që synon të mbrojë lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e deputetëve të Parlamentit Evropian, duhet të konsiderohet si një imunitet absolut që pengon çdo proces gjyqësor në lidhje me një opinion të shprehur ose një votë të dhënë gjatë ushtrimit të detyrave në parlament”*. Në rastin konkret nuk rezulton që të ndodhemi përballë këtyre kushteve, pra, kërkesa e organit të akuzës nuk rezulton që të ketë lidhje me veprimtarinë e deputetit z.Sali Berisha, në Kuvendin e Shqipërisë.

Neni 289 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se *“Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo kur nga hetimet rezultojnë fakte apo rrethana të reja, prokurori mund t'i kërkojë Kuvendit autorizimin, sipas paragrafit 1 të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale”*.

Neni 231 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se *“ në rast shkelje të detyrimit që lidhet me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljet që lidhen me masa ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese”*.

Neni 260 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se *“kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund*

të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë.....”

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vlerësuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova se personi në hetim Sali Berisha ka kryer veprën penale të “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 260 e 25 të Kodit Penal.

Në kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar parashtrohet se personi nën hetim plotëson kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe në bazë të akteve që shoqërojnë kërkesën për Prokurorinë e Posaçme ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të Kodit të Procedurës Penale se personi nën hetim Sali Berisha në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga ligji procedural penal në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij duke mos u paraqitur para oficerit të Policisë Gjyqësore.

Në lidhje me pretendimin e avokatëve të z. Sali Berisha se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për autorizim me qëllim zëvendësimin e masës së sigurimit është e pabazuar në kushtet kur vjen si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore që konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën nga ana e klientit të tyre, për arsye se dhe për masën e sigurimit “detyrim për paraqitje” dhe “ndalim për të udhëtuar jashtë shtetit”, Prokuroria e Posaçme nuk duhet të anashkalonte Kuvendin, por të paraqiste kërkesë për dhënie autorizimi (referimi në çështjen Saimir Tahiri) para se t’i drejtohej gjykatës, ky Këshill çmon të arsyetojë se:

Në rastin në shqyrtim, Këshilli dhe Kuvendi kanë detyrimin të respektojnë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Rezulton se për masat e sigurimit ndaj deputetit Sali Berisha “detyrim për paraqitje” dhe “ndalim për të udhëtuar jashtë shtetit”, gjykata e juridiksionit të posaçëm është shprehur me vendim. Konkretisht:

Me vendimin nr. 112 date 20 .10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke caktuar masat e sigurimit personal të sipërcituara për personin nën hetim z.Sali Berisha.

Me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë ka vendosur ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues *"Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale , caktuar me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ndaj personit nën hetim Sali Berisha, duke u urdhëruar ky i fundit të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, para oficerit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe urdhërimi i këtij shtetasi të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233, pika 1, të K.Pr.Penale dhe ndalimi i

përdorimit të pasaportës dhe dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

Duke mos qenë dakord me dy vendimet e mësipërme, nga ana e personit nën hetim dhe mbrojtësve të tij është ushtruar ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tirane.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, **me vendimin nr. 56, datë 21.11.2023**, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të verifikuar me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 të së njëjtës gjykatë, ndaj ankuesit z. Sali Berisha.

Në këto kushte, për rastin në shqyrtim, ndryshe nga çështja që ka shqyrtuar Kuvendi më parë, për rastin e deputetit Saimir Tahiri, Këshilli nuk mund të vlerësojë bazueshmërinë e pretendimit të avokatëve të deputetit Z. Sali Berisha, nëse duhej të paraqitej një kërkesë në Kuvend për autorizim për masa e sigurimit “detyrim për paraqitje” dhe “ndalim për të udhëtuar jashtë shtetit” nga Prokuroria e Posaçme, para se kjo prokurori t’i drejtohej gjykatës së posaçme, pasi këto pretendime janë shqyrtuar, vlerësuar e vendosur me vendime gjyqësore. Është parim i përgjithshëm se vendimet e gjykatave janë detyrueshme dhe nuk mund të çënohen përveçse nga një gjykatë tjetër më e lartë. Nuk rezulton në asnjë nga vendet demokratike dhe ku respektohet ndarja e pushteteve, që organi ligjvënës, të kontrollojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore. Edhe në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, ku për një kohë të gjatë Dhoma e Lordëve e Parlamentit shërbente si gjykata më e lartë në vend, u hoq dorë me reformën kushtetuese të vitit 2005, duke krijuar për këtë qëllim në vitin 2009 Gjykatën e Lartë në atë vend. Për rrjedhojë, Këshilli nuk ka asnjë tagër kushtetuese apo ligjore të mos konsiderojë një vendim gjykate dhe as të interpretojë ndryshe nga përmbajtja e tij, pasi do të cenonte parimin e shtetit të së drejtës, ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe pavarësinë e pushtetit gjyqsor.

KONKLUZIONE

Deputetët e shumicës parlamentare në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, duke vlerësuar parimet kushtetuese për funksionimin e shtetit të drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, barazisë para ligjit së të gjithë shtetasve, respektimit të të drejtave të njeriut dhe garancive procedurale në hetim dhe procesin penal, me qëllim që drejtësia të ushtrojë funksionet e veta në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, në zbatim të nenit 73 të Kushtetutës, nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 13 dhe 118 të Rregullores së Kuvendit, i rekomandojmë Kuvendit:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për dhënien e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit, Z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit nga ajo e “*Detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, parashikuar nga neni

233 i K.Pr.Penale, në atë të arrrestit në burg/arrest në shtëpi, parashikuar nga nenet 238/237 të K.Pr.Penale.

DEPUTETËT

Bledar Çuçi Ermonela FELAJ (Valikaj) Klotilda BUSHKA Arben PËLLUMBI

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA